

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me Kryetaren e kolegjit Afijete Sada-Gllogjani, Shpresa Manxhuka dhe Ismet Këndusi, anëtar, në çështjen juridike të propozuesve S.D. nga Gjakova, të cilin e përfaqëson M.S. avokat nga Gjakova dhe L.D.e vajzërisë D. nga Gjakova, përfaqësuar nga i autorizuari A.G. nga Gjakova, për zgjidhje të martesës shkurorezim me marrëveshje, në shqyrtimin përgatitor jopublik, në prezencën e të autorizuarve të propozuesve të mbajtur me datë 27 gusht 2019, murr këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET shkurorezohet martesë me marrëveshje në mes të propozuesve S.D., data e lindjes..., në Gjakovë me vendbanim në Kroaci dhe propozueses L.D.e vajzërisë D., data e lindjes..., në Gjakovë tani me vendbanim në Suedi e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë numër rendor ..., numri i referencës ... me datë ...

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhje të martesës me marrëveshje të lidhur para ofiqarit të Gjendjes Civile në Gjakovë me datë ..., nr. rendor ... Nga kjo martesë propozuesit përkatësisht ish bashkëshortët kanë lindur dy fëmijë, A.D.1. data e lindjes..., dhe A.D.2. data e lindjes.... Në martesë faktike propozuesit kanë qëndruar deri në fund të vitit 1989, propozuesi jeton në Zagreb të Kroacisë kurse propozuesja në Suedi.

Propozuesit konsiderojnë se deri tek ndarja kanë ardhur për shkak të sjelljeve dhe edukatave të tyre të ndryshme, mos ambientimi i tyre në rrethanat e reja të krijuara pas lidhjes së martesës, e të cilat në një mënyrë edhe i kanë çrregulluar thellë marrëdhëniet bashkëshortore, ashtu që jeta e tyre e mëtejme e përbashkët është bërë e padurueshme dhe tani që prej shumë kohëve jetojnë dhe veprojnë ndaras. Lidhur nga këto të thëna kanë vendosur që bashkësinë martesore ta zgjidhin dhe kanë paraqitur propozim të përbashkët për zgjidhje të martesës me marrëveshje. Raportet e tyre martesore nuk kanë mundësi të rivendosjes për shkak të ftohjes dhe mos kontaktimit të tyre me dekada të tëra.

Gjatë shqyrtimit i autorizuari i propozuesit mbet në tërësi pranë propozimit duke ritheksuar faktin se propozuesit gjatë jetës së përbashkët kanë dy fëmijë, A.1. dhe A.2. që të dy të moshës madhore. Propozuesit jetojnë të ndarë për shumë vite nga ndarja faktike. Konsideroi se janë plotësuar kushtet ligjore që kjo martesë të zgjidhet me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve. Propozoj që propozimi të aprovohet. Shpenzime procedurale nuk kërkoj. Hoqi dorë nga e drejta në ankesë kundër aktgjykimit.

I autorizuari i propozueses gjatë shqyrtimit mbet në tërësi pranë propozimit duke deklaruar që martesë të zgjidhet me propozim të përbashkët. Shpenzime procedurale nuk kërkoj. Hoqi dorë nga e drejta në ankesë kundër aktgjykimit.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave, certifikatës së martesës të lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovës nr..., numri i referencës ... të datës ..., certifikatës së lindjes nr..., numri i referencës ... të datës 12 qershor 2019 dhe certifikatës së lindjes nr..., numri i referencës ... të datës 12 qershor 2019 ku pas vlerësimit veç e veç të tyre dhe në

lidhshmërinë e tyre reciproke në kuptim të nenit 8 të LPK-së aprovoj propozimin për zgjidhje të martesës.

Nga certifikata e martesës u vërtetua se bashkëshortët kanë lidh martesë me datë ...në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë. Gjatë jetës së përbashkët martesore kanë dy fëmijë të përbashkët madhor A.D.1. data e lindjes..., dhe A.D.2. data e lindjes...

Duke u gjendur pranë kësaj gjendje faktike Gjykata konsideron se martesë nuk ka funksionuar nga kjo martesë ka humbur qëllimin dhe efektin e vetë për të cilën është lidh. Me qenë se në rastin konkret mungojnë këto elemente qenësore, për ekzistimin e martesës, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të caktuara në dispozitën e nenit 69 pika 2 të Ligjit për Familjen të Kosovës, ku janë paraparë shkaqet e veçanta të shkurorëzimit ndër të tjera dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr sipas nenit 450 të LPK-së dhe deklarimit të autorizuarve të propozuesve.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C. nr. 447/19, Datë 27 gusht 2019

Kryetarja e Kolegjit
Afijete Sada-Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Palët në procedurë kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë dhe ky Aktgjykim është i formës së prerë.